

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi autoritetin bankar dhe të pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 44 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

Rregullin 18 mbi Anëtarësimin dhe Kontratat e Jashtme

Neni 1

1. Shtrirja e Rregullit

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuar nga BPK-ja

2. Autoriteti Ligjor

Ky rregull implementon Nenin 44, kapitullin VI (Çështjet Prudenciale) të rregullave të sigurimit.

3. Definicionet

Në këtë rregull termet në vijim nënkuptojn:

“Kontrata e anëtarësimit” është një kontratë apo marveshje ku kompania e dorëzon (paraqet) vetën tek menaxhmenti apo ndonjë entiteti tjetër, apo kryen vet transferin në të gjitha pjesët e asaj kompanie.

“Bordi i Drejtorëve” nënkupton rangimin më të lartë të trupit drejtues të një Korporate të përbërë nga anëtarët të zgjedhur me votim të barabartë. Në kete rregull termi “Bordi i Drejtorëve” i referohet:

a) Në raste të Korporatës apo kompanisë të themeluara dhe që veprojnë sipas ligjeve të Kosovës, Bordi i Drejtorëve e organizon veten.

b) Në raste të kompanisë së huaj të inkuorporuar në juridiksion tjetër, por e cila është e licencuar për t’u marrë me biznesin e sigurimit në Kosovë, zyrtari i lartë i kompanisë, në zyrat në Kosovë, i cili është banorë i Kosovës dhe është pranuar si i till nga BPK.

“Bordi” i referohet bordit të drejtorëve siç është definuar në rregull.

“Zotërimi i entitetit” apo “kontrollimi i entitetit” nënkupton një person apo firmë, partneritet, korporatë apo shoqatë që është pronar apo e zotëron, në mënyrë direkte apo indirekte, më shumë se 50% të drejtën e barazisë së votës në kompani.

“Kompania” i referohet njëres apo të dyjave, kompanisë së sigurimeve apo kompanisë së ndërmjetësuesve.

“Kontratat e Jashtme” apo të jashtme nënkupton transferin e disa funksioneve të rëndësisë së materialit, për kryerje të shëndosh të operacioneve të një kompanie ndaj entitetit tjetër, pa marr parasysh se entiteti është kompani tjetër e sigurimeve apo ndërmjetësues i sigurimit.

“Zyrtari i lartë” është niveli më i lartë i zyrtarit të një kompanie, pa marr parasysh se a e përdor titullin e Kryetarit, Nënkyetarit, Drejtorit Menaxhues, Përfaqesues i Vendit, Menaxher, apo ndonjë titull tjetër.

Section 2

Kontrata e Anëtarësimit

1. Miratimi nga BPK

Asnjë kompani nuk do të mund të hyjë në kontratë anëtarësimi apo marrëveshje pa miratimin nga BPK. Në lirin e saj të veprimit; BPK mund të miratojë një kontratë për anëtarësim apo marrëveshje kur është e bindur se kërkesat e mëposhtme janë plotësuar.

a) Bordi i drejtorëve të kompanisë dorëzon kontratën e propozuar dhe dokumentat tjera të kërkuara nga BPK në mënyrë që BPK-së t’i sigurojë informatat adekuate dhe të arsyeshme që të mund të rishikoj dhe vlerësojë kontratën e propozuar për anëtarësim apo marrëveshjen.

b) Kontrata e propozuar është në mes kompanisë dhe entitetit të saj posedues

apo kontrollues.

- c) Zotërimi apo kontrollimi i entitetit me të cilin kompania ka propozuar të hyjë në kontratë anëtarësimi, e dorëzon atë autoriteteve të rregullave dhe mbikëqyrjes në BPK, dhe nuk mund në asnjë mënyrë të ndërhyjë në mbikëqyrjen efektive të kompanisë nga BPK. Këto janë kushtet të cilat duhet të përcaktohen, kuartë, në kohë dhe kushte të kontratës apo marrëveshjes.

Në rast të zotërimit nga i huaji apo kontrollimi i entitetit, kontrata apo marrëveshja duhet të sigurojë rregullat shtesë të rregullores dhe mbikëqyrjes të BPK, mbi çështjet e biznesit siç janë zotëruesit e huaj dhe kontrollorët e entitetit dhe marrëveshja apo kontrata duhet të nënshkruhen dhe të konfirmohen nga autoritetet relevante në juridikaturën e huaj.

- d) Të gjithë drejtorët dhe personat menaxhues, zotërues apo kontrollues të Entitetit, duhet t'i përshtaten testit të përshkruar të BPK-së si i përshtatshëm.
- e) Kontrata apo marrëveshja, duhet të sigurojnë se cdo transfer apo profit nga Kompania për zotëruesit apo kontrolluesit e entitetit mendohet se është pagesë e pjestueshme, deklarata dhe pagesa e të cilës është subjekt i miratimit të mëhershëm të BPK.
- f) Kontrata apo marrëveshja duhet të përmbajë të gjitha dispozitat tjera ashtu siç janë të përshkruara nga BPK.

Neni 3 Kontratat e Jashtme

1. Kufizimet

Neni 44 i rregullores së sigurimeve, u'a ndalon kompanive të sigurimit që t'i nënkontraktoj aktivitetet operative parimore të sigurimit. Përveq se në pajtim me rregullin e miratimit të kontratës së anëtarësimit apo marrëveshjes në pajtim me nenin 2 të kësaj rregulle, një kompani nuk mundet të nënkontraktoj aktivitetet apo funksionet me sa vijon:

- a) Vlerësimi i rrezikut dhe nënshkrimi i rrezikut.
- b) Fatura e premive dhe grumbullimi.

- c) Raportimi i dëmeve dhe pagesa.
- d) Investimi i premive të pranuar.
- e) Ndonjë aktivitet apo funksion tjetër, që mund të udhëhiqet nga BPK-ja.

2. Kontratat e Jashtme të Lejuara

Me miratimin paraprak të BPK, cdo aktivitet apo funksion i kompanisë që nuk është i kufizuar në pajtim me alinen 1, mund të nënkontraktohet entitetit tjetër. BPK, në bazë të lirisë së veprimit, mund t'i miratoj nënkontratat e propozuara apo marëveshjet kur mendon se kërkesat e mëposhtme janë përmbushur:

- a) Bordi i drejtorëve të kompanisë e dorëzon kontratën e propozuar apo marëveshjen me justifikimin për nënkontraktimin besueshëm të aktivitetit apo funksionit të kompanisë. Dorëzimi duhet t'i përfshijë të gjitha dokumentet të cilat kërkohen nga BPK-ja, në mënyrë që të siguroj informata të arsyeshme dhe adekuate për BPK, për të bërë vlerësimin dhe rishikimin e propozimit.
- b) Kushtet e kontratës apo marëveshjes i rezervojnë kompanisë të drejtën që të nxjerr instruksionet dhe direktivat në çështjen, funksionimi apo transferimi aktivitetit është i shkarkuar nga entiteti i pranueshëm.
- c) Kontrata e jashtme apo marëveshja nuk e shkarkon kompaninë nga Përgjegjësia e polisambajtësve të saj dhe kreditorët e tjerë, dhe nuk zvogëlon përgjegjësin e mirëbesimit të bordit dhe të kompanisë ndaj polisambajtësve.
- d) Kontrata apo marëveshja do të siguroj se BPK-ja ka fuqin që të bëjë inspektimet në vend mbi funksionet nënkontraktuese apo aktivitetet për të siguruar se ato janë bërë në pajtim me rregulloren e sigurimeve dhe këto rregulla si edhe direktivat të nxjerra dhe në përputhje me BPK.
- e) Nëse entiteti pranues gjendet nën jurudiksionin e huaj, kontrata apo marëveshja duhet të ofroj mbikqyrje shtesë BPK-së dhe një kontratë e till apo marëveshje e till duhet të nënshkruhet dhe të konfirmohet nga autoritetet e huaja relevante.
- f) Nëse nënkontrata përfshinë transferin e funksioneve apo aktiviteteve tek ndonjë nëvartës apo anëtar, rregullimet kontraktuese janë të përshtatshme për biznesin kryesor rreth pranimit vartës apo anëtar dhe që transaksioni të përputhet me kërkesat e përshkruara nën rregullin 56 (Palët lidhura me transaksion) të këtyre rregullave.
- g) Kontrata apo marëveshja përmbanë të gjitha dispozitat që mund të kërkohet

hen nga BPK-ja.

3. Kontrata e jashtme në dobi të aplikantit apo kompanisë së licencuar

Nëse kontrata apo marëveshja nënkontraktuese transferohet tek një kompani e licencuar, për aktivitete apo funksione nga një entitet tjetër, miratimi paraprak nga BPK duhet të sigurohet. BPK, në bazë të lirisë së veprimit, mund ta miratojë kontratën apo marëveshjen nëse janë përmbushur:

- a) Aktiviteti nënkontraktues apo funksioni është një pjesë e biznesit sigurues, apo është një sigurim i lidhur me aktivitetin të biznesit të kompanisë në pajtim me rregullën 47, të këtyre rregullave.
- b) Nëse transaksioni nënkontraktues përfshinë palët kontraktuese të cilat i përkasin të njëjtit grup, dhe entiteti pranues është një kompani pranuese, siç është definuar në këtë rregull, dispozitat aplikuese e alines 2 të këtij neni, po ashtu duhet të jenë në pajtim, si shtesë e kërkesës të përshkruar në paragrafin a).

Neni 4 Pajtueshmëria

1. Efekti i mos miratimit nga BPK-ja

Nëse anëtarësimi, nënkontraktuesi apo marëveshja e propozuar nuk është miratuar nga BPK, nëse objektivat e BPK-së në ndonjë përmbajtje të saj, apo nëse BPK-ja përshkruan ndonjë dispozicion që duhet të përfshihet në kontratë apo marëveshje, BPK-ja do ta njoftoj kompaninë me shkrim duke i specifikuar objektivat e saj dhe/apo kërkesave të saj. Nëse objektivat nuk mund të përfshihen, apo nëse dispozitat shtesë nuk mund të përfshihen, në anëtarësim apo nënkontraktim apo marëveshje, nuk do të miratohet nga BPK-ja, dhe nuk do të mund të jetë e zbatueshme, adoptuar apo implementuar nga kompania.

Nëse kompania zbaton, adopton apo implementon një anëtarësim apo lidhje nënkontraktuese me ndonjë entitet tjetër pa kontratë të definuar apo marëveshje e cila duhet të miratohet nga BPK-ja.

- a) Aplikacioni për licencim të kompanisë mohohet menjëher.
- b) Licenca e kompanisë do të revokohet nga BPK mund të marrë hapa të mëtutjeshëm sipas nevojës, në pajtim me dispozitat e rregullores së sigurimeve dhe këtyre rregullave.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky rregull, do të hyj në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman
Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral